



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS  
FAKULTETI I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT  
DEPARTAMENTI I BAZAVE TË INFORMATIKËS



Tiranë, më 28/09/2021

Lënda: Kërkesë për kandidim.

**DEKANATIT TE FTI**

**Këtu**

E nderuar Zonja Dekane,

Departamenti i Bazave të Informatikës, mbështetur në kornizën ligjore në fuqi në nivel kombëtar si edhe të asaj të UPT dhe FTI, ju përcjell kriteret e aplikimit për personel akademik me kohë të pjesëshme ose me kontratë (PAK), në Departamentin e Bazave të Informatikës për vitin akademik 2021-2022, që kandidatët duhet të dorëzojnë pranë këtij departamenti si edhe specifikat e lëndëve dhe të komponenteve mësimore të tyre, për të cilat Departamenti i Bazave të Informatikës ka nevojë, që të mbulohen nga personel akademik me kohë të pjesëshme.

**I. Dosja që do të dorëzojë kandidati, duhet të përmbajë, dokumentat si më poshtë:**

1. CV e kandidatit;
2. Fotokopje e ID;
3. Fotokopje e noterizuar e diplomës Bachelor në Inxhinieri Informatike dhe Master i Shkencave në Inxhinieri Informatike në FTI, UPT ose të diplomave ekuivalente me to, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi;
4. Listë e noterizuar e notave e studimeve Bachelor dhe Master i Shkencave, ose i studimeve të ekuivalentuara sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi;
5. Nota mesatare e ponderuar (për të dy ciklet e studimit së bashku  $\geq 7.5$ , është kusht detyrues hyrës);
6. Për kandidatët të cilët kanë të paktën gradën “Doktor” apo tituj akademik nuk kërkohet nota mesatare;
7. Dy rekomandime nga personeli akademik me titull Profesor ose Prof. Asoc i FTI, UPT ose i Universitetit/Fakultetit ku kandidati ka kryer studimet;
8. Leje me shkrim nga titullari i institucionit/kompanisë ku është i punësuar, që lejon angazhimin e kandidatit në mësimdhënie si pedagog me kohë të pjesëshme në FTI, UPT për vitin akademik 2019-2020.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS  
FAKULTETI I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT  
DEPARTAMENTI I BAZAVE TË INFORMATIKËS



**II. Specifikat e nevojave të Departamentit të Bazave të Informatikës** për personel akademik PAK, në Ciklin e Parë të studimeve (Bachelor) për lëndët që mbulohen nga DBI në fakultetet e UPT, si më poshtë:

❖ **FIM, FIE, FGJM dhe FIN**

Nr	Semestri I dhe II Emërtimi i lëndës	Kreditet përkatëse (KFU – Kredite të Formimit Universitar)
1	<b>Elementët e Informatikës</b>	2.5 KFU seminar dhe 0.5 KFU laborator
	ose	ose
	<b>Bazat e Informatikës</b>	3 KFU seminar
	ose	ose
	<b>Informatika</b>	1.5 KFU seminar dhe 0.5 KFU laborator

Ju falenderoj për bashkëpunimin,

**Prof. Aleksandër XHUVANI**  
Përgjegjës i Departamentit të Bazave të Informatikës